



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:063519
Datë: 14.05.2024
Numri i dokumentit: 05680611

PPP.nr.20/24

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit I.H. nga fsh ..., Komuna e Ferizajt, të cilin me autorizim e përfaqëson av Visar Musa nga Ferizaj, kundër debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor- Organi Shpronësues, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, për pagesën e borxhit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga përfaqësuesi i debitorit, me datë 14.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i përfaqësuesit të debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor- Organi Shpronësues, i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit P.nr.93/2024, të datës 07.02.2024, i lëshuar nga Përmbartuesi Sh.L. nga Ferizaj, dhe **MBETET në fuqi** urdhri për përmbartim P.nr.93/2024, i datës 07.02.2024.

A r s y e t i m

Me urdhrin P.nr.93/2024, të datës 07.02.2024, Përmbartuesi privat Sh.L., e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga kreditori I.H., kundër debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor- Organi Shpronësues, për pagesën e borxhit në shumë prej 33,572.00 euro, dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 2,604 euro, si dhe shpenzimet e procedurës së përmbartimit, në bazë të aktvendimit CN.nr.101/20, të datës 19.04.2023, të lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, ose bllokimin e të gjitha

llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e shumës së mjeteve në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, përfaqësuesi i debitorit, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, me të cilin i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar dhe ta shfuqizoj urdhrin për përmbarim.

I autorizuari i kreditorit, në përgjigjen e ushtruar me shkrim, në prapësimin e përfaqësuesit të debitorit, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përmbarim të atakuar me prapësim dhe pretendimet në prapësim të përfaqësuesit të debitorit dhe vlerësoj se prapësimi është i pabazuar dhe nuk i plotëson asnjërin nga kushtet e parapara në nenin 71, par 1, të LPP-së.

Në të vërtetë, Gjykata vlerëson se urdhri për përmbarim P.nr.93/2024, i datës 07.02.2024, i lëshuar nga Përmbaruesi Privat Sh.L., është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore, ngase përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori në bazë të nenit 22, par 1, nën par 1.1, të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Sa i përket pretendimeve të përfaqësuesit të debitorit në prapësim se pala debitore ka shpreh vullnetin ta përmbaroj vullnetarisht obligimin për pronën e shpronësuar por kreditorët kanë shkelur Ligjin e procedurës së përmbarimit duke mos pritur kohën për përmbushje vullnetare, gjykata këtë pretendim e konsideron të pabazuar sepse nga shkresat e lëndës, gjegjësisht nga aktvendimi CN.nr.101/20, të datës 19.04.2023, në bazë të cilit është caktuar përmbarimi me nxjerrjen e urdhrin për përmbarim nga Përmbaruesi privat, vërtetohet se kreditori I.I. propozimin e tij për përmbarim e ka ushtruar, gjegjësisht e ka dorëzuar tek përmbaruesi privat pas kalimit të afatit paritiv (vullnetar) të cekur në aktvendimin e përmendur më lart. Për më tepër, aktvendimi në fjalë është bërë i plotfuqishëm nga data 06.09.2023 dhe i ekzekutueshëm nga data 24.11.2023, kurse kreditori, respektivisht i autorizuari i tij, propozimin për përmbarim e ka dorëzuar me datën 07.02.2024, që nënkupton se kreditori e ka ushtruar propozimin për përmbarim kundër debitorit pas kalimit të afatit vullnetar prej 15 ditësh.

Po ashtu, sa i përket pretendimit të përfaqësuesit të debitorit në prapësim se Përmbaruesi privat, me rastin e lejimit të përmbarimit nuk i ka vlerësuar drejtë dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore, Gjykata edhe këtë pretendim e konsideron të pabazuar sepse nga shkresat e lëndës, vërtetohet se Përmbaruesi privat Sh.L., urdhrin për përmbarim

P.nr.93/2024, të datës 07.02.2024, e ka nxjerrë në pajtim me nenin 22, par 1, nën par 1.1, të LPP-së, për arsye se aktvendimi CN.nr.101/20, i datës 19.04.2023, në bazë të cilit është nxjerrë urdhri për përmbnim, konsiderohet dokument përmbnimor, gjegjësisht i plotëson të gjitha kushtet ligjore nga neni 22, par 1, nën par 1.1, të LPP-së, për tu konsideruar dokument përmbnimor, sepse i njëjti është i pajisur edhe me klauzolën e përmbnueshmërisë për përmbnueshmëri, respektivisht është i plotfuqishëm nga data 06.09.2023 dhe i ekzekutueshëm nga data 24.11.2023, që nënkupton se në këtë rast janë plotësuar edhe kushtet ligjore nga neni 36, par 1, të LPP-së.

Përveç tjerash, gjykata vlerëson se aktvendimi CN.nr.101/20, i datës 19.04.2023, është në tërësi i përshtatshëm për përmbnim dhe në pajtim me nenin 27, par 1, të LPP-së, për arsye se në të është treguar debitori dhe kreditori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbnuesjes së detyrimit, që është afati prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit.

Gjithashtu, Gjykata konstaton se i autorizuar i kreditorit, propozimin për përmbnim e ka përpiluar në pajtim të plotë me nenin 38, par 1, të LPP-së, sepse propozimi siç shihet e përmban kërkesën për përmbnim në të cilën është treguar dokumenti përmbnimor siç është aktvendimi i përmendur më lart, në kopje të vërtetuar, kërkesin e përmbnimit dhe debitorin dhe të dhënat e tyre rreth adresës së tyre, apo selisë së debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe të dhënat tjera të cilat janë të nevojshme për zbatimin e përmbnimit.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.20/24, më datë 14.05.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të